

TV KLAN Sh.a



Pasqyrat financiare

per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021

(dhe raporti i audituesit te pavarur)

Permbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar	2
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithëpërshiresë	3
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital	4
Pasqyra e flukseve monetare	5
Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare	6-26



TV KLAN SHA

Pasqyra e pozicionit financiar me 31 Dhjetor 2021 (Vlerat ne Lek)

Me ndarje ne afatshkurter dhe afatgjate	Shenimi	Periudha Raportuese 2021	Periudha Raportuese 2020
AKTIVET			
Aktive afatgjate			
Aktive afatgjata materiale	7	1,061,696,890	1,126,570,760
Aktive te tjera afatgjata jo-materiale	8	324,670	475,795
Investime ne pjesmarje	9	455,190,860	449,599,915
Totali i aktiveve afatgjata		1,517,212,420	1,576,646,471
Aktive afatshkurtra			
Inventare dhe aktive biologjike afatshkurter	10	(0)	6,016,592
Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme	11	598,444,108	1,041,703,665
Aktive te tjere financiare afatshkurter	12	2,759,377,434	828,501,422
Tatim fitimi i parapaguar	13	16,788,910	213,944
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	14	48,293,497	26,141,883
		3,422,903,949	1,902,577,506
Totali i aktiveve afatshkurtra		3,422,903,949	1,902,577,506
TOTALI I AKTIVEVE		4,940,116,370	3,479,223,977
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nenshkruar dhe primi i kapitalit		1,449,520,014	1,449,520,014
Rezerva te tjera (pershkruaj)		206,172,257	126,970,478
Fitime/(humbje) te mbartura		267,313,259	278,869,779
		1,923,005,530	1,855,360,271
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike		1,923,005,530	1,855,360,271
Totali i kapitalit		1,923,005,530	1,855,360,271
Detyrime afatgjata			
Huamarrje	15	307,797,589	589,233,327
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	17	887,012,891	-
Totali i detyrimeve afatgjata		1,194,810,480	589,233,327
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	17	1,315,519,643	447,233,586
Huamarrje	16	251,016,417	311,320,984
Detyrime financiare te tjera	18	195,838,845	211,488,852
Dividente per tu paguar	19	59,925,455	64,586,957
		1,822,300,360	1,034,630,379
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,822,300,360	1,034,630,379
Detyrime totale		3,017,110,839	1,623,863,706
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		4,940,116,370	3,479,223,977



TV KLAN SHA

Këto pasqyra financiare janë aprovuar më 31 Mars 2022 dhe janë firmosur në emër të tij nga:

Administratore
Eglantina Lamaj



Hartoi pasqyrat financiare
Tirana Financial Consulting



Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 (Vlerat në Lek).

	Shenimi	Periudha Raportuese 2021	Periudha Raportuese 2020
Aktivitetet e vazhdueshme			
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit			
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	20	2,040,053,474	1,432,586,126
Te ardhura të tjera		-	1,468,272
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	7	(172,737,673)	(169,462,924)
Shpenzime personeli	22	(545,035,633)	(464,369,738)
Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto	23	29,943,911	4,354,141
Shpenzime të tjera	24	(1,121,361,739)	(565,465,586)
Pjesa e fitimit/(humbjes) nga pjesëmarrjet (filjal/dege)	25	-	977,464
Fitimi/(humbja) para tatimit		230,862,340	240,087,757
Tatimi mbi fitimin	26	(40,217,081)	(37,885,978)
Fitimi/(Humbja) e periudhës nga aktiviteti i vazhdueshëm		190,645,259	202,201,779
Fitimi/(Humbja) e periudhës (A)		190,645,259	202,201,779

TV KLAN SH.A

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 (Vlerat ne Lek)

	Kapitali i nenshkuar	Rezerva te tjera (pershkruaj)	Fitimet/ (humbjet) e pashperndara	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali
Pozicioni financiar ne fillim	1,449,520,014	118,404,208	-	171,334,270	1,739,258,492
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:					-
Fitim/(humbja) e periudhes				202,201,779	202,201,779
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse			171,334,270	(171,334,270)	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	-	-	171,334,270	30,867,509	202,201,779
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					-
Emetim i kapitalit te nenshkuar					-
Dividende te shperadare		8,566,270	(94,666,270)		(86,100,000)
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)					-
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	8,566,270	(94,666,270)	-	(86,100,000)
Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)	1,449,520,014	126,970,478	76,668,000	202,201,779	1,855,360,271
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:					-
Fitim/(humbja) e periudhes				190,645,259	190,645,259
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse			202,201,779	(202,201,779)	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	-	-	202,201,779	(11,556,519)	190,645,259
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					-
Emetim i kapitalit te nenshkuar					-
Dividende te shperadare		79,201,779	(202,201,779)		(123,000,000)
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)					-
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	79,201,779	(202,201,779)	-	(123,000,000)
Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)	1,449,520,014	206,172,257	76,668,000	190,645,259	1,923,005,530



Prokuratori i Përgjithshëm
J. H. H.

TV KLAN SH.A

Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 (Vlerat ne Lek)

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 31 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

	Periudha Raportuese 2021	Periudha Raportuese 2020
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	190,680,361	202,201,779
Rregullime per te ardhura dhe shpenzime jo-monetare:		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	172,737,673	169,867,816
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit		
Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	8,621,118	(539,516,496)
Renie/(Rritje) ne inventar	6,016,592	1,530,912
Rritje/(Renie) ne detyrime te pagueshme	2,184,519,990	212,780,190
Rritje/(Renie) ne detyrime per punonjesit	6,791,143	(4,692,536)
Te tjera (pershkruaj)	(1,952,596,370)	(208,281,937)
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	600,195,542	(166,110,273)
Tatim fitimi i paguar gjate periudhes		
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(148,757,780)	(254,131,214)
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	35,454,157	(404,892)
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	(113,303,623)	(254,536,106)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
Hua te arketuara	275,506,428	210,410,715
Pagesa e huave	(617,246,733)	291,783,970
Dividende te paguar pronareve te njesive ekonomike meme	(123,000,000)	(86,100,000)
Dividende te paguar interesave jokontrollues	-	-
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	(464,740,306)	416,094,685
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to	22,151,614	(4,551,694)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	26,141,883	30,693,577
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	48,293,497	26,141,883



Prokuratori Gjeneral
J. Lloshi

1 Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "TV Klan" sh.a. (këtu e më poshtë "Shoqëria") është themeluar me datën 12/02/1997 si një Shoqëri Aksionare me NUIS J71413001L. Shoqëria ushtron aktivitetin privat që prej vitit 1997, e regjistruar me numrin e vendimit 16941 në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është veprimtaria në fushën e medias televizive. Selia qendrore e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga Aleksander Moisiu, Nr. 97.

Aksionarët e Shoqërisë janë:

Emri i Aksionerit	Numri i aksioneve	% e aksioneve ne kapital	Vlera e aksioneve
Aleksander Frangaj	245,250	60	869,712,008
Alba Gina	163,500	40	579,808,006
Total	408,750	100	1,449,520,014

- Me 31 Dhjetor 2021 Shoqëria administrohet nga Z. Aleksander Frangaj (2020: Z. Aleksander Frangaj).
- Me 31 Dhjetor 2021 Shoqëria kishte 433 punonjes (2020: 359)

3. Politika kontabël të rëndësishme

3.1 Baza e përgatitjes dhe përputhshmërisë

3.1.1 Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KINRF") të BSNK. Zbatimi i SNRF-ve është sipas Ligjit Nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e vlerësimit janë përshkruar në mënyrë më të qartë në politikat kontabël të paraqitura si më poshtë.

3.1.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

3.2 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në "Lek" e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

3.3 Përdorimi i gjykimit dhe i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i shoqërisë të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që mund të ndikojnë në aplikimin e politikave si dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet kryesore janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme në të cilën mund të ketë ndikim.



Robert Allani
J. Allani

3.4 Parimi i vijimesisë

Te dhënat e kontabilitetit janë mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhes, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

Pasqyrat financiare jane pergatitur sipas parimit te vijimesise, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjate ecurise normale te biznesit.

3.5 Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Të gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo-monetare nuk ri këmbehen në fund të periudhës dhe maten me kosto historike (këmbehen duke përdorur kursin e këmbimit në datë kur është kryer transaksioni), përveç rasteve kur zërat jo-monetare maten me vlerë të drejtë të cilat këmbehen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të aplikuara (*Lek kundrejt monedhave të tjera të huaja*) për monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

Pershkrimi i monedhes	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
USD	106.54	100.84
EUR	120.76	123.70
GBP	143.95	137.93

3.6 Aktivët afatgjatë materiale

3.6.1 Njohja dhe matja

Elementet e aktiveve afatgjatë materiale mbahen me kosto historike pakësuar zhvlerësimin e akumuluar (si më poshtë) dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (referohuni politikën kontabël 3.6).

Kostot historike përfshijnë të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë përfshin kostot e materialeve dhe punën direkte, dhe çdo kosto tjetër të atribueshme për sjelljen e aktivit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktivit si dhe rregullimin e vendit në të cilin janë vendosur dhe kapitalizimin e koston së huamarrjeve.

Në rastet kur elementet e një aktiviti material afatgjatë kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato mbahen si aktive afatgjatë materiale më vete (komponentët kryesore).

3.6.2 Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjatë materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivitetit vetëm në qoftë se parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve materiale afatgjatë njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.



3.6.3 Zhvlerësimi (Amortizimi)

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën me vlerë të mbetur të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën me të shkurtër midis periudhës së qirase dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndertesa	Mbi vlerën kontabel neto	5%
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabel neto	20%
Mjete transporti	Mbi vlerën kontabel neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabel neto	25%
Mobilje dhe orëndi	Mbi vlerën kontabel neto	20%

Vlera e mbetur dhe jetëgjatësia e aktiveve afatgjatë materiale shqyrtohet, dhe rregullohet nëse është e përshtatshme, në çdo datë të Pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera kontabël e një aktivit shpenzohet menjëherë deri në shumën e rikuperueshme, nëse vlera kontabël e aktivit është më e madhe se shumën e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohet duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitimin ose humbjen e periudhës financiare.

3.7 Aktivët afatgjatë jo-materiale

Aktivët afatgjatë jo-materiale të blera nga shoqëria paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (nëse ka), bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar pas datës së cilës ato janë të gatshme për përdorim. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjatë jo-materiale shqyrtohet, në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Aktivët afatgjatë jo-materiale	Metoda lineare	15%

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohen në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë vlera e rikuperueshme e aktivit rivekëtohet. Kur vlera kontabël e tejkalon vlerën e rikuperueshme, njihet një humbje nga zhvlerësimi. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

3.7.1 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivit ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e vogël se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet apo grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivit ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme skontojnë për të sjellë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

Në lidhje me aktivet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se ka ndonjë tregues që ky zhvlerësim nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në masën që vlera kontabël e aktivit nuk



Prokuror
[Signature]

TV KLAN SH.A

kalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, në qoftë se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk është njohur.

3.8 Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rjedhën normale të biznesit, minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

Kostot e inventarit përcaktohen duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar, e cila përfshin të gjitha kostot e blerjes, transportit, tarifave doganore dhe sigurimit gjatë transportit, kostot e konvertimit dhe çdo kosto tjetër që lidhet me inventarin për të sjellë atë në vendin dhe kushtet e punës.

3.9 Instrumentet financiare

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentave financiarë dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit, me përjashtim të atyre të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes të cilat fillimisht janë të matura me vlerë të drejtë dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në fitimin ose humbjen.

3.9.1 Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare.

SNRF 9 përmban tre kategori kryesore të klasifikimit për aktivet financiare: matur me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse ose me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 në përgjithësi bazohet në modelin e biznesit në të cilin menaxhohet një aktiv financiar dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit financiar. SNRF 9 eliminon kategoritë e mëparshme të SNK 39, të mbajtura deri në maturim, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të mbajtura për shitje. Sipas SNRF 9, derivativët e përfshirë në kontratat ku baza është një aktiv financiar në këndvështrimin e standardit nuk ndahen kurrë. Në vend të kësaj, instrumenti financiar hibrid si një i tërë vlerësohet për klasifikim.

SNRF 9 kryesisht ruan kërkesat ekzistuese në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e pasiveve financiare. Miratimi i SNRF 9 nuk ka pasur efekt të rëndësishëm në politikat kontabël të Kompanisë lidhur me pasivet financiare. Efekti i adoptimit të SNRF 9 mbi vlerat kontabël të aktiveve financiare më 1 Janar 2018 lidhet vetëm me kërkesat e reja të zhvlerësimit.

3.9.2 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

SNRF 9 zëvendëson modelin e humbjeve të ndodhura në SNK 39 me një model të humbjes së pritshme të kredisë. Modeli i ri i zhvlerësimit zbatohet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Sipas SNRF 9, humbjet nga kreditë njihen më herët se në SNK 39. Për aktivet në kuadër të modelit të SNRF 9, humbjet nga zhvlerësimi zakonisht priten të rriten dhe të bëhen më të paqëndrueshme.

3.10 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitet me vlerën në Lek të konvertuar me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale.

3.11 Njohja e të ardhurave

Sipas SNRF 15 të ardhurat do të njihen në masën që është pothuajse e sigurtë se një kthim në sasinë e të ardhurave të akumuluarra të njohura nuk do të ndodhë. Kështu e ardhura matet duke u bazuar në



TV KLAN SH.A

shumen e percaktuar ne nje kontrate me klientin ose ne listen e cmimeve te Shoqerise. Shoqeria e njeh te ardhuren atehere kur ajo transferon kontrollin mbi sherbimin ose mallin tek klienti.

Shoqeria do te njohe te ardhurat ne nje pike ne kohe qe do te perfaqesohet nga momenti qe klienti pranon sherbimet e ofruara nga shoqeria si edhe merr persiper rreziqet e ketij transferimi te sherbimeve, me supozimin se nuk do te kete kthime te rendesishme ne keto sherbime.

3.11.1 Shitjet e shërbimeve

Të ardhurat njihen gjatë kohës kur ofrohen shërbimet. Faza e përfundimit për përcaktimin e shumës së të ardhurave për t'u njohur vlerësohet bazuar në anketat e punës së kryer. Nëse shërbimet sipas një marrëveshjeje të vetme jepen në periudha të ndryshme raportimi, atëherë shumat ndahet në bazë të çmimeve të tyre të shitjes.

3.12 Përfitimet e punonjësve

3.12.1 Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të punonjësve për pjesën që ligjërisht i takon të paguajë shoqërisë dhe punonjësve për të kontribuar për fondet e detyrueshme të pensioneve sipas rregullimeve të legjislacionit vendas. Kostot e shoqërisë janë përfshirë në llogaritjen e rezultatit të periudhës.

3.13 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyre

Shpenzimet për tatim fitimin përfshijnë tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyre. Shpenzimet për tatim fitimin njihen në fitim ose humbje deri përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 15% e fitimit të tatueshëm.

Tatim fitimi i shtyre njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat tatimore që pritet të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke u bazuar në ligjet që kanë qenë ose janë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyre njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivët tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në qoftë se përfitimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.

3.14 Provizionet

Provizionet njihen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin dhe kur një vlerësim i besueshëm i vlerës së detyrimit mund të bëhet. Nëse efekti është material, provigjoni llogaritet duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhshme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, dhe kur është e nevojshme rrezikun specifik të detyrimit.

Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin, provigjoni



TV KLAN SH.A

anullohet. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në kontabilitet

Provizionet për kthimin e mallrave të shitura do të njihen si "detyrime për kthimin e shitjeve" për vlerën e të ardhurave nga shitja e tyre me kundraparti pakësimin e të ardhurave nga shitja; dhe "te drejta për kthimet e shitjeve" për të pasqyruar te drejtën për të rimarrë produktet nga konsumatorët në zgjidhjen e përgjegjësisë për rimbursim, me kundraparti pakësimin e kostos së mallrave të shitura.

3.15 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënime shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënime shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjonin. një detyrim njihet në datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

3.16 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

3.17 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare.

Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënime shpjeguese kur janë materiale.

4. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

a. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive nga data 1 janar 2020 por ato nuk kanë patur ndryshime në pasqyrat financiare të shoqërisë. Këto ndryshime janë paraqitur më poshtë:

- Ndryshimet në Kuadrin Konceptual (në fuqi më 1 janar 2020).
- Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e biznesit" (në fuqi më 1 janar 2020).
- Ndryshimet në SNK 39 "Instrumentat financiar: Njohja dhe matja", SNRF 7 "Informacionet shpjeguese për instrumentat financiar", dhe SNRF 9 "Instrumentat financiar" (në fuqi më 1 janar 2020).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).



b. Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të papërvetësuara

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të shoqërisë, janë paraqitur më poshtë:

- Ndryshimet në SNRF 3 për disa referenca nga ndryshimet e Kuadrit Konceptual (në fuqi më 1 janar 2022)
- Ndryshimet në SNK 37 "Provizionet, aktivet dhe detyrimet e kushtezuara" (në fuqi më 1 janar 2022)
- Ndryshimet në SNK 16 "aktivet afatgjata materiale" (në fuqi më 1 janar 2022)
- Ndryshimet në SNA 1 në klasifikime (në fuqi më 1 janar 2023).
- Ndryshimet në shenimet për politikat kontabel (në fuqi më 1 janar 2023).
- Ndryshimet në SNK 18 "Politikat kontabel, vlerësimet dhe gabimet" (në fuqi më 1 janar 2023).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).

c. SNRF 16 – Qiratë

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 Qiratë. Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabel të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit.

Standarti eliminon modelin aktual të kontabilitetit të dyfishtë për qiramarrësit dhe në vend të saj kërkon që shoqëritë të pasqyrojnë qiratë në bilanc sipas një modeli të vetëm, duke eliminuar dallimin mes qirasë operative dhe financiare.

Sipas SNRF 16, kontrata është, ose përmban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Për kontrata të tilla, modeli i ri kërkon që qiramarrësi të njohë një aktiv për të cilin ka të drejtën e përdorimit si dhe një detyrim. Aktiv i zhvlerësohet dhe detyrimi akumulon interes. Kjo do të rezultojë në një model ku shpenzimet janë më të larta në periudhën fillestare dhe më pas vijnë duke u ulur për shumicën e qirave, edhe nëse qiramarrësi paguan kështu fikse vjetore, norma efektive e interesit të aplikuar është 4.5%.

Një qiramarrës mund të zgjedhë të mos zbatojë kërkesat e standartit për:

- qiratë afatshkurtra dhe;

qiratë për të cilin aktivi bazë është me vlerë të ulët.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar

a. Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare, që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut, si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kreditit, dhe investimi i likuiditetit të tepërt. Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- risku i kreditimit,
- risku i likuiditetit, dhe



- risku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe manaxhimin e riskut dhe manaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Politikat e manaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të manaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

b. Risku i kreditimit

Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kreditimit, i cili është risku që një palë e tretë do të shkaktojë një humbje financiare për Shoqërinë duke mos paguar detyrimin. Risku i kreditimit është më i rëndësishmi ndaj të cilit përball Shoqëria dhe si rrjedhim Drejtimi duhet ta menaxhojë me kujdes ekspozimin ndaj riskut të kreditimit. Risku i kreditimit lind parimisht në aktivitetet e shitjes që sjellin si rezultat të drejta për t'u arkëtuar, dhe aktivitetet e investimit që sjellin Tituj të tjerë në portofolin e aktiveve të Shoqërisë. Risku i kreditimit lind nga paratë dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare, depozitat në bankë dhe institucionet financiare, si dhe ekspozimi i kreditimit ndaj klientëve, duke përfshirë kërkesat për t'u arkëtuar dhe angazhimet në transaksione. Për bankat dhe institucionet financiare, merret në konsideratë vlerësimi i pavarur.

Nëse klientët janë të vlerësuar në mënyrë të pavarur, përdoret ky tregues. Në të kundërt, nëse nuk ka ndonjë tregues të vlerësimit të pavarur, kontrollit i riskut vlerëson cilësinë e kreditimit ndaj klientëve, duke marrë në konsideratë pozicionin e tij financiar, eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë. Kufizimet e riskut individual vendosen bazuar në treguesit e brendshëm ose të jashtëm në përputhje me limitet e vendosura nga Shoqëria. Përdorimi i limitit të kredisë monitorohet në vazhdimësi.

Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta matet në shumën që konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqet e mundshme në arkëtimin e balancave të llogarive të arkëtueshme. Mosarkëtimi i llogarive të arkëtueshme nuk është gjykuar si i pamundur ndaj dhe shoqëria nuk llogarit zhvlerësim.

i. Ekspozimi ndaj riskut të kreditimit

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj riskut të kreditimit.

Maksimumi i ekspozimit ndaj riskut të kreditimit më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 është paraqitur më poshtë:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	48,293,497	26,141,883
Llogari te arkëtueshme tregtare	598,537,775	587,523,666
Te tjera te arkëtueshme	2,143,710	18,408,387
Te tjere debitoare	824,156,810	708,717,644
Totali	1,473,131,792	1,340,791,580

c. Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek Shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit



TV KLAN SH.A

